



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORE

RAPORT PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT

VITI 2024

1. Hyrje

Buxheti i Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024 përfaqëson një instrument të rëndësishëm të zbatimit të politikave zhvillimore të miratuara nga Këshilli, në funksion të përmbushjes së objektivave institucionale, në përputhje me kornizën ligjore dhe strategjike për menaxhimin fiskal dhe administrimin e shpenzimeve publike.

Ky raport paraqet një pasqyrë të detajuar të punës së realizuar nga administrata e Këshillit të Qarkut gjatë vitit 2024, duke evidentuar veprimtarinë buxhetore, ecurinë e realizimit të të ardhurave dhe nivelin e zbatimit të shpenzimeve, në përputhje me programet buxhetore të planifikuara. Në fokus të raportit janë rezultatet e arritura në lidhje me:

- Administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave vendore;
- Zbatimin eficient dhe efektiv të shpenzimeve publike;
- Përmbushjen e objektivave strategjike për ofrimin e shërbimeve në standarde sa më të larta për komunitetin e qarkut.

2. Përshkrim i shkurtër mbi profilin e Qarkut Vlorë

Qarku i Vlorës është një ndër qarqet me shtrirjen më të gjerë gjeografike në Republikën e Shqipërisë, që përbëhet nga 7 bashki: Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Finiq, Konispol dhe Delvinë. Me një sipërfaqe prej 2,706 km², qarku kufizohet me detin Jon dhe detin Adriatik, dhe ka një vijë bregdetare prej 244 km, si dhe një kufi tokësor prej 54 km.

Sipas të dhënave të gjendjes civile, popullsia e përgjithshme e qarkut është 380,184 banorë, ndërsa popullsia rezidente rezulton të jetë 146,681 banorë. Ky potencial njerëzor, së bashku me pozicionin gjeostrategjik dhe pasuritë natyrore, përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

3. Misioni dhe roli institucional i Këshillit të Qarkut Vlorë

Këshilli i Qarkut Vlorë, në përmbushje të funksioneve të veta ligjore dhe kushtetuese, ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, në përputhje dhe në bashkëpunim me politikat kombëtare, si dhe ushtrimin e funksioneve të tjera të përcaktuara me ligj.

Në këtë kuadër, Këshilli i Qarkut:

- Siguron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim ndërmjet bashkive të qarkut dhe institucioneve të qeverisjes qendrore;
- Promovon projekte të përbashkëta zhvillimore në fushat e infrastrukturës, turizmit, mbrojtjes së mjedisit, edukimit dhe përfshirjes sociale;
- Mbështet një proces vendimmarrjeje gjithëpërfshirës, transparent dhe të orientuar drejt nevojave të komunitetit;
- Synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve publike dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve në të gjithë territorin e qarkut.

4. Objektivat e Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024

Një ndër objektivat kryesorë të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024 ka qenë rritja e të ardhurave të brendshme, nëpërmjet arkëtimit të tarifave të urbanistikës dhe DAMT, si dhe përpjekjet për të siguruar kontribute financiare, veçanërisht nga njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë), përmes kuotës së tyre vjetore.

Në zbatim të pikës 3, të nenit 38 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, çdo bashki brenda territorit të Qarkut të Vlorës është e detyruar të derdhë një kuotë anëtarësie vjetore, të përcaktuar në buxhetet e tyre përkatëse dhe të miratuara në këshillat bashkiakë.

Të ardhurat që i vihen në dispozicion Këshillit të Qarkut Vlorë mundësojnë financimin e projekteve, studimeve dhe investimeve në njësitë vendore, me fokus të veçantë tek ato bashki me kapacitet më të ulët të të ardhurave. Në këtë kontekst, objektivat madhore të

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

përcaktuara për vitin 2024 kanë qenë:

- Hartimi i Planit Sektorial dhe Social, si një dokument strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të qarkut;
- Krijimi i partneriteteve zhvillimore, për promovimin e një modeli bashkëpunimi të qëndrueshëm rajonal;
- Nxitja e bashkëpunimit ndër-bashkiak dhe ndër-rajonat, për të rritur ndikimin e projekteve me interes të përbashkët;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike dhe forcimi i qeverisjes vendore me parime transparence, përgjegjshmërie dhe eficiencë.

5. Parimet themelore në zbatimin e buxhetit të vitit 2024

a. Buxheti i balancuar dhe transparent.

Zbatimi i buxhetit të vitit 2024 është kryer në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke përfshirë:

- Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2024”;
- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;
- Udhëzimin nr. 1, datë 24.01.2024, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”.

Buxheti ka qenë i balancuar – të ardhurat kanë qenë në përputhje të plotë me shpenzimet. Arkëtimet dhe shpenzimet janë raportuar në mënyrë periodike dhe transparente, në përputhje me aktet ligjore dhe procedurat përkatëse.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

b. Besueshmëria e planifikimit.

Buxheti është hartuar mbi bazën e burimeve të pritshme të të ardhurave dhe është mbështetur në një analizë realiste të mundësive të financimit, duke siguruar likuiditet të mjaftueshëm për përballimin e shpenzimeve gjatë gjithë vitit.

c. Eficienca dhe e fektiviteti.

Buxheti është zbatuar me qëllimin për të optimizuar përdorimin e burimeve financiare, duke garantuar një shpërndarje të drejtë dhe të orientuar drejt shpenzimeve kapitale dhe shërbimeve me ndikim të drejtpërdrejtë tek komuniteti.

6. Strukturimi dhe burimet e buxhetit për vitin 2024

Në përputhje me ligjet për vetëqeverisjen vendore dhe menaxhimin e financave publike, buxheti i Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024 është ndërtuar në bazë të këtyre komponentëve:

Burimet e financimit:

- Të ardhurat e vetë institucionit;
- Transferta e pakushtëzuar (Granti nga buxheti i shtetit);
- Transferta e kushtëzuar (Grantet e dedikuara për DAMT dhe qëndrën psiko-sociale “Vatra”).

Funksionet financiare të buxhetit:

- Financimi i funksioneve të veta institucionale;
- Financimi i funksioneve të përbashkëta me bashkitë;
- Financimi i funksioneve të deleguara nga qeveria qendrore.

Të ardhurat janë parashikuar sipas një metodologjie bazuar në ecurinë historike të arkëtimit dhe realizimin faktik të periudhave të mëparshme. Llojet kryesore të të ardhurave të realizuara përfshijnë:

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

- Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve të ofruara nga institucioni;
- Kontributet financiare nga bashkitë sipas detyrimeve ligjore për anëtarësi;
- Të ardhurat e trashëguara nga viti buxhetor 2023, të cilat janë përdorur për të mbuluar shpenzimet korrente dhe kapitale të vitit 2024.

7. Vështrim i përgjithshëm mbi buxhetin e vitit 2024

Karakteristikat kryesore të ecurisë së buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024 përfshijnë:

- Realizimin në mënyrë të kënaqshme të treguesve të performancës në arkëtimin e të ardhurave nga tarifat dhe kontributet vendore;
- Rritjen e peshës së investimeve në krahasim me vitet e mëparshme;
- Zbatimin me korrektësi të planifikimit buxhetor në përputhje me legjislacionin dhe objektivat strategjike të përcaktuar në fillim të vitit.

Të ardhurat

Zëri i të ardhurave	Plani (në lekë)	Realizimi (në lekë)	% e realizimit
Të ardhura të trashëguara nga viti 2023	32,214,489	32,214,489	100%
Grant i trashëguar nga viti 2023	44,116,939	44,116,939	100%
Të ardhura të planifikuara për vitin 2024	17,300,000	18,449,244	106%
Grant i pakushtëzuar 2024	60,386,671	60,386,671	100%

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Të ardhura të deleguara (Kadastra)	9,983,000	9,983,000	100%
Grant i kushtëzuar (Shërbimi përkujdesit social – Q. Vatra)	17,426,948	17,426,948	100%
TOTALI	181,428,047	182,577,291	100,6%

Të dhënat mbi realizimin e të ardhurave tregojnë një performancë të përgjithshme të kënaqshme dhe në përputhje me planifikimet fillestare, me një realizim total prej 182,577,291 lekë, krahasuar me planin prej 181,428,047 lekë, që përkthehet në një nivel realizimi prej 100,6%.

Të ardhurat e trashëguara (nga viti 2023)

- Të ardhurat e trashëguara në shumën 32,214,489 lekë janë realizuar plotësisht (100%).
- Kjo tregon një menaxhim të mirë të fondeve të mbartura, duke garantuar përdorimin e tyre për vijimësinë e aktiviteteve buxhetore në vitin 2024.

Grantet e trashëguara nga viti 2023

- Edhe ky zë është realizuar në mënyrë të plotë (100%), duke treguar përputhje të mirë me strukturën e financimeve të pakonsumura nga viti i mëparshëm, si dhe ruajtjen e destinacionit të tyre për përdorim sipas objektivave.

Të ardhurat e planifikuara për vitin 2024

- Ky është zëri me rritjen më pozitive, ku realizimi ka tejkaluar planifikimin me 106%

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

(18,449,244 lekë ndaj 17,300,000 lekë).

- Të ardhurat e mbledhura nga burimet e veta (tarifat dhe kontributet e bashkive) reflektojnë një administrim aktiv dhe eficient, si dhe një disiplinë më të mirë financiare të njësive vendore në raport me derdhjen e kuotave të tyre të anëtarësisë.

Granti i pakushtëzuar për vitin 2024

- Realizimi i plotë i grantit prej 60,386,671 lekë është tregues i sigurisë së financimit nga buxheti i shtetit dhe i stabilitetit të linjës buxhetore për shpenzime operative dhe kapitale të institucionit.

Të ardhurat e deleguara (Kadastra).

- Ky zë gjithashtu ka realizim të plotë, duke dëshmuar funksionim të mirë të marrëdhënies institucionale dhe procedurave të bashkëpunimit ndërinstitucional për shërbime të deleguara.

Grant i kushtëzuar për shërbimin e përkujdesit social (Qendra “Vatra”)

- Realizimi i plotë i këtij granti tregon zbatim të saktë të fondeve të dedikuara për shërbimet sociale.

ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR VITIN 2024 NË LEKË

SHPENZIME KORRENTE

I. Realizimi i Shpenzimeve të Qarkut Vlorë për vitin 2024.

Pasqyra Nr.1

Nr	EMËRTIMI			
		Plan	Fakt	%

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

1.	Administrata (Grant)	104,503,610	50,625,535	48%
	Paga personeli Art (600)	23,000,171	15,758,549	65
	Sigurime Shoqërore Art (601)	4,547,500	2,586,747	55
	Shpenzime Operative Art (602)	20,494,026	13,477,041	65
	Transferta te brendshme (604)	10,030,879	7,997,315	79
	Fond i vecante (609)	2,743,764	0	0
	Investime Art (231)	43,687,270	10,805,883	24
2.	Administrata (Të ardhurat)	49,514,489	12,631,562	25%
	Shpenzime Operative Art (602)	11,304,113	0	0
	Transferta te brendshme (604)	9,800,000	9,800,000	100
	Transferta te jashtme (605)	500,000		0
	Investime Art (231)	27,910,376	2,831,562	10
3.	Transferta e Kushtëzuar	27,409,948	22,972,041	83%
4.	Transferta e Kushtëzuar (DAMT)	9,983,000	7,167,268	71%
	Paga personeli Art (600)	8,250,000	5,867,729	70
	Sigurime Shoqërore Art (601)	1,433,000	1,001,403	71
	Shpenzime Operative Art (602)	300,000	298,136	99
5.	Transferte e Kushtëz (Qendra Psiko-Sociale Vatra)	17,426,948	15,804,187	90%
	Paga personeli + Sigurime Shoqërore Art (606)	17,426,948	15,804,187	90

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Totali Qarku	181,428,047	86,229,126	47%
--------------	-------------	------------	-----

I. Analiza analitike e Shpenzimeve për vitin 2024 – Administrata

Shpenzimet e përgjithshme për administratën e Këshillit të Qarkut Vlorë gjatë vitit 2024 janë realizuar në shumën 63,257,097 lekë, kundrejt një plani vjetor prej 154,018,099 lekë, që përbën 41% të realizimit total.

Shpenzimet Korrente për Administratën e Qarkut

a. Shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve (artikujt 600 + 601)

Realizimi i shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit për vitin 2024 është bërë në përputhje me strukturën organike të miratuar. Numri i punonjësve të administratës së paguar nga fondi i grantit të pakushtëzuar ishte 13.

- **Paga personeli:** Plan i ishte 23,000,171 lekë, u realizuan 15,758,549 lekë – 65% realizim;
- **Sigurime shoqërore:** Plan i ishte 4,547,500 lekë, u realizuan 2,586,747 lekë – 55% realizim.

b. Shpenzimet operative dhe mirëmbajtje (artikulli 602)

Për vitin 2024, fondi i planifikuar për shpenzime operative ishte 20,494,026 lekë, ndërsa realizimi arriti në 13,477,041 lekë, që përbën 65% të programit.

c. Transfertat e brendshme (artikulli 604)

Në këtë zë përfshihen transfertat për Shoqatat, bashkitë e qarkut dhe pagesa TVSH . Nga 10,030,879 lekë të planifikuara, u realizuan 7,997,315 lekë, ose 79% e fondit.**d. Fondi i veçantë (artikulli 609)**

Për vitin 2024 ishte planifikuar në vlerën 2,743,764 lekë, por nuk është përdorur – 0%

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

realizim.

e. Shpenzimet Kapitale – Investimet (artikulli 231)

Për vitin 2024, për investime u planifikua një fond prej **43,687,270 lekë**, nga i cili u realizuan **10,805,883 lekë**, me një përqindje realizimi **24%**. Ky nivel i ulët realizimi lidhet kryesisht me vonesa në procedurat administrative, por edhe sepse për keto investime procedurat e prokurimit përfundojnë në vitin 2025.

II. Analiza analitike e Shpenzimeve për vitin 2024 – Administrata (nga të ardhurat)

Nga të ardhurat vetjake të siguruara nga institucioni, për vitin 2024 u planifikuan 49,514,489 lekë, ndërsa u realizuan 12,631,562 lekë, duke reflektuar një nivel realizimi 25%.

- Shpenzime operative (Art. 602): Plani ishte 11,304,113 lekë, 0 lekë të realizuara – 0% realizim.
- Transferta të brendshme (Art. 604): Plani ishte 9,800,000 lekë, dhe është realizuar plotësisht – 100%.
- Transferta të jashtme (Art. 605): Plani ishte 500,000 lekë, por nuk u realizua – 0%.
- Investime (Art. 231): Nga 27,910,376 lekë të planifikuara, u realizuan 2,831,562 lekë, ose 10%.

III. Analiza analitike e Shpenzimeve për vitin 2024 – Transferta e Kushtëzuar (DAMT)

Transferta e kushtëzuar për Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) për vitin 2024 ishte në vlerën 9,983,000 lekë, nga e cila u realizuan 7,167,268 lekë, ose 71%.

- Paga personeli: Plani 8,250,000 lekë, realizim 5,867,729 lekë – 70%.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

- Sigurime shoqërore: Plani 1,433,000 lekë, realizim 1,001,403 lekë – 71%.
- Shpenzime operative: Plani 300,000 lekë, realizim 298,136 lekë – 99%.

IV. Analiza analitike e Shpenzimeve për vitin 2024 – Qendra Psiko-Sociale “Vatra”

Për vitin 2024, transfertat e kushtëzuar për Qendrën Psiko-Sociale “Vatra” ishte 17,426,948 lekë, nga të cilat janë realizuar 15,804,187 lekë, që përfaqëson 90% të fondit të alokuar.

Ky fond është përdorur për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve të qendrës:

- Paga dhe sigurime (Art. 606): Plani 17,426,948 lekë, realizim 15,804,187 lekë – 90%.

Gjatë vitit 2024, zbatimi i buxhetit të administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë është kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe objektivat e përcaktuara në programin vjetor. Menaxhimi i fondeve është orientuar drejt garantimit të funksionimit institucional, mbështetjes së strukturave në nivel vendor dhe rritjes së eficiencës në përdorimin e burimeve publike.

Shpenzimet korrente janë realizuar në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me nevojat funksionale të institucionit, duke ruajtur balancën ndërmjet disiplinës fiskale dhe garantimit të vazhdimësisë së shërbimeve publike. Nga ana tjetër, realizimi i shpenzimeve kapitale ka qenë më i kufizuar, për shkak të sfidave procedurale dhe administrative që lidhen me proceset e prokurimit.

Pavarësisht vështirësive të hasura, zbatimi i buxhetit ka reflektuar kujdes dhe përgjegjshmëri në përdorimin e fondeve publike, duke siguruar stabilitet funksional dhe mbështetje për prioritetet institucionale të vitit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Grupi I punës:

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Anisa Hyseni

Specialist Finance për Zbatimin e Buxhetit

Mauricio Pashaj

KRYETAR

ERVIS MOÇKA

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al

E-mail: info@qarkuvlore.gov.al

Tel: +355 33 421 600